



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/16  
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Financimit të Subjekteve Politike.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrat dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Ramush HARADINAJ  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

---

**KONCEPT DOKUMENT PËR FUSHËN E FINANCIMIT TË SUBJEKTEVE  
POLITIKE**

**Kapitulli I**

**Hyrje:**

Qëllimi i këtij koncept dokumenti është rritja e transparencës dhe llogaridhënieve me qëllim të përmirësimit të qeverisjes së mirë dhe funksionimit demokratik të institucioneve si dhe të subjekteve politike.

Financimi i subjekteve politike në Republikën e Kosovës është i rregulluar me Ligjin nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-212.

Me këtë ligj, ndër të tjera rregullohet mënyra dhe kushtet e financimit të subjekteve politike, mbikëqyrja, transparenca dhe raportimi për shpenzimet e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës.

Avancimi i mëtejmë i kornizës ligjore për sa i përket financimit të subjekteve politike është kërkesë e cila del nga Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së, Agjenda për Reforma Evropiane si dhe nga standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së, ka përcaktuar që: *Në kuadër të reformës zgjedhore dhe me qëllim të përbushjes së obligimeve të cilat dalin nga raportet e BE-së për Kosovën, Kosova duhet të plotësoj-ndryshoj Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe të themelohet një autoritet i pavarur, jo KQZ-ja, që të jetë përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike. Konkretisht, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të angazhohet që të themeloj Komisionin Ad Hoc për reformë zgjedhore, të cilit do t'i siguroj buxhet, për të përbushur obligimet të cilat dalin nga ky proces. Ndërsa, më qëllim të zbatimit të Ligjit për Financimin e Partive Politike, Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të angazhohet në krijimin e një dikasteri në kuadër të KQZ-së ose në kuadër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.*

Për më tepër, poashtu edhe Agjenda për Reforma Evropiane ka përcaktuar që të sigurohet transparencë dhe llogaridhënie e subjekteve politike, të publikohen raportet financiare të subjekteve politike, të ofrohet financim adekuat për

prokurimin e shërbimeve të auditimit për raportet financiare të subjekteve politike, të përzgjidhen auditorët e pavarur nëpërmjet thirrjes së hapur.

Me qëllim të realizimit të kërkesave të lartcekura, është përcaktuar që të iniciohet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Financimin e subjekteve politike.

Në rrjedhë të obligimeve të marra nga dokumentet e lartcekura, Zyra e Kryeministrat ka themeluar ekipin përgjegjës për hartimin e Koncept dokumentit për politikën "Financimi i subjekteve politike". Në përbërjen e ekipit përgjegjës janë përfaqësues nga Zyra e Kryeministrat, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm Ministria e Financave, Ministria e Integrimit Evropian etj.

Ekipi përgjegjës poashtu ka të drejtë që në procesin e hartimi të koncept dokumentit të përfshij akterë tjera dhe organizata të ndryshme te cilat merren me monitorimin e financimit të subjekteve politike. Në këtë aspekt Zyra e Kryeministrat ka ftuar përfaqësues nga Shoqëria Civile të cilët kanë ofruar mendimet dhe propozimet e tyre se si ky proces mund të adresohet.

## Kapitulli II

### Përshkrimi dhe definimi i çështjes / problemit

Procesi i transparencës në financimin e subjekteve politike është një problematikë e cila një kohë të gjatë ka qenë temë e diskutimit nga institucionet relevante, dhe poashtu edhe si shqetësim i dalur nga raportet e ndryshme të organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

Mungesa e transparencës në financimin e subjekteve politike si dhe mungesa auditimit të financave të subjekteve politike vazhdimisht ka qenë shqetësim i organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, organizatave jo qeveritare si dhe një gjë e tillë është përmendur edhe në raportet e rregullta të Komisionit Evropian.

Nga Plani Kombëtarë për Zbatimin e MSA-së Agjenda per Reforma Evropiane, si dhe në bazë të konsultimeve me anëtarët e ekipit përgjegjës për hartimin e koncept dokumentit, është vërejtur se janë dy çështje kryesore të cilat kanë ngecje në zbatim për sa i përket Ligjit për Financimin e subjekteve politike.

Çështja e parë ka të bëjë me auditimin e të hyrave dhe shpenzimeve të subjekteve politike, dhe çështja e dytë me publikimin e raporteve vjetore financiare dhe deklarimit finansiar të fushatës.

Neni 19 i Ligjit NR. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-058 përcakton se: *Raportet Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ, do të auditohen në përputhje me standarde kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë, nga auditorë të cilët do ti përzgjedh*

*Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike nëpërmjet një thirrje të hapur publike për aplikim.*

Në këtë nen përcaktohet që: *KQZ-ja duhet t'i publikoj dhe t'i mbaj të publikuar të gjitha raportet vjetore financiare të subjekteve politike së bashku me reportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike në faqen e saj zyrtare më së largu deri më 30 qershor të vitit pasues. Po ashtu, deri më këtë datë KQZ-ja obligohet t'i përcjellë subjektit politik reportin përfundimtar të auditimit.*

Vështirësitetë në zbatimin e nenit 19 kanë qenë në kryerjen e auditimeve të raporteve vjetore financiare të subjekteve politike, për shkak të mos përzgjedhjes së auditorëve nga ana e Kuvendit. Edhe pse Ligji përcakton që personat fizik apo juridik mund të përzgjedhen për kryerjen e auditimit të raporteve të subjekteve politike, Kuvendi ka hasur në vështirësi të gjendjes së dhjetë auditorëve të licencuar, për të kryer veprimet të cilat dalin nga neni 19 i këtij ligji.

Në mungesë të auditimit të raporteve financiare, KQZ dhe subjektet politike aspektin e publikimit të raporteve financiare e shohin si proces të ndërlidhur ngushtë me auditimin e atyre raporteve, se nëse raportet nuk auditohen, subjektet politike nuk kanë për obligim ti publikojnë ato.

Sipas njoftimeve të KQZ-së, auditimet e raporteve financiare të partive politike janë bërë vetëm deri në vitin 2012.

Në rrjedhë të kësaj, vlen të përmendet që nga të gjitha subjektet politike të cilat funksionojnë në vend, është vetëm një subjekt politik i cili ka bërë publike raportet vjetore financiare.

Nga kjo dispozitë, KQZ duke interpretuar dispoziten e nenit 19 paragrafi 10, nuk ka bërë publikimin e raporteve vjetore financiare, duke konsideruar se publikimi i këtyre raporteve duhet të bëhet bashkarisht me raportet përfundimtare të auditimit.

Përveç kësaj, nga KQZ është përmendur sfiduese edhe pamundësia e gjobitjes së subjekteve politike të cilat nuk kanë ulëse në Kuvend ku sipas tyre një gjë e tillë është e pamundur për shkak të mungesës së bazës ligjore në ligj. Poashtu pamundësia e gjobitjes së subjekteve politike të cilat nuk posedojnë ueb faqe zyrtare të subjektit politik, në të cilën do të publikonin të gjitha raportet financiare.

Mungesa e stafit profesional në Zyrën për regjistrimin e partive politike në kuadër të KQZ-së, është përmendur se është një sfidë me të cilën është përballur në vazhdimësi ky Institucion.

Aktualisht nuk ka mekanizëm për monitorimin e financave të subjekteve politike. Për dallim nga auditimi i cili kontrollon vetëm raportet vjetore dhe raportet e

fushatave, monitorimi do të mund të kontrollonte në proces të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike, me theks të vecantë gjatë fushatave zgjedhore.

Institucionet të cilat kanë përbërje politike, nuk do të duhej që të kenë mandat në fushën e monitorimit dhe kontrollit të financave të subjekteve politike, për shkak se kjo mund të paraqesë situatë të mundshme konfliktit të interesit.

Një çështje e tille derivon edhe nga Udhëzuesi për rregullativen e subjekteve politike, i OSBE ODHIR-it dhe Komisionit të Venedikut, i datës 15-16 tetor 2010.

Gjithashtu një nga problemet aktuale është edhe Neni 9 paragrafi 4 e ligjit Nr. 04/L-212 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e subjekteve politike, i cili përcakton se: *dlijetë përqind (10%) e shumës së ndarë nga Fondi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, të shkojnë për mbështetjen e punës së secilit deputet.*

Sipas kësaj dispozite del se 10% e shumës së ndarë nga Fondi per mbështetjen e subjekteve politike shkon për secilin deputet, e jo për mbështetjen e grupeve parlamentare sic do të duhej të ishte.

Është e rëndësishme qe gjobat e parapara me Ligjin për financimin e subjekteve politike, të harmonizohen me Ligjin për Kundërvajtje.

Neni 15 i ligjit bazik i cili me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-212, i është shtuar paragrafi 5 i cili përcakton se: *Subjektet politike duhet të publikojnë dhe të mbajnë të publikuar së paku një (1) vit në faqet e tyre zyrtare Raportin Vjetor Financiar të viti paraprak dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës së zgjedhjeve paraprake dhe ta publikojnë versionin tyre të shkurtuar në njëren nga gazetat ditore kombëtare. Formatin e versionit të shkurtër për publikim e përcaktion KQZ-ja përmes një akti nënligjor.*

Kjo dispozite ligjore nuk e përcakton afatin brenda të cilit duhet të publikohet në ueb faqet e tyre raporti vjetor financiar dhe raporti i deklarimit financiar të fushates.

Gjithashtu, publikimi i këtyre raporteve do të duhej të bëhej pavarësisht faktit nëse ato janë audituar ose jo.

### **Politika aktuale:**

Zyra e Kryeministrit me qëllim që të njoftohet më për së afërmi me këtë problematikë, ka parashtruar disa pyetje në formë të shkruar drejtuar institucioneve të cilat merren me subjektet politike, duke përfshirë edhe disa nga Organizatat e Shoqërisë Civile të cilat merren me këtë çështje.

Nga përgjigjet e marra, mund të konkludohet se ekziston një përcepcion se dispozitat ligjore ofrojnë hapësirë për mos zbatimin e obligimeve për sa ka të bëjë me publikimin dhe auditimin e raporteve të subjekteve politike.

Në bazë të Ligjit për Financimin e Subjekteve politike, janë disa institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, si: Kuvendi i Kosovës, KQZ, AKK dhe subjektet politike.

**Kuvendi i Kosovës** e ka për obligim që përmes konkursit publik të bëjë përzgjedhjen e auditorëve të licencuar, të cilët duhet të auditojnë raportet financiare dhe raportet e deklarimit financier të subjekteve politike.

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** ka për obligim publikimin e raporteve vjetore financiare të subjekteve politike, reportin vjetor të fushatës dhe reportin e audimit të raporteve të subjekteve politike.

**Subjektet politike** kanë për obligim që ti publikojnë raportet e tyre vjetore financiare dhe raportet financiare të shpenzimeve të fushatës në ueb faqet e tyre zyrtare, dhe dërgimin e atyre raporteve në KQZ.

#### **KUVENDI:**

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Financimin e subjekteve politike, Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në muajin janar të çdo viti përzgjedh me konkurs publik së paku dhjetë (10) auditorë të licencuar të cilët do të auditojnë Raportet Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së subjekteve politike.

Për t'u përzgjedhur auditorët duhet të plotësohen disa kritere të cilat janë të përcaktuara në Nenin 19 parografi 2 të Ligjit.

Pas përzgjedhjes së listës së auditorëve, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kjo listë do të caktojë me short auditorët të cilët do të janë përgjegjës për auditimin e raporteve të subjekteve politike. Një auditor nuk mund të auditojë dy herë radhazi raportet financiare të një subjekti politik.

#### **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE:**

Përgjegjësitë e KQZ-së dhe subjekteve politike për sa i përket publikimit të raporteve financiare të subjekteve politike nuk është realizuar, pasi që Kuvendi i Republikës së Kosovës nga viti 2012/2013 ka dështuar në përzgjedhjen e Auditorëve, dhe kështu nuk është realizuar auditimi i raporteve financiare të subjekteve politike. Në këtë drejtim, KQZ dhe subjektet politike publikimin e raporteve financiare e kan ndërlidhur me nevojen për auditimin e këtyre raporteve.

KQZ -ja ia paraqet rezultatet paraprake të kontrollimit të raportit vjetor financier nga auditorët organit më të lartë ekzekutiv të subjektit politik, duke përfshirë edhe listën e gabimeve ose lëshimeve brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga fillimi i kontrollimit.

Raportet Vjetore Financiare dhe Raport të Deklarimit Financiar të Fushatës të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ, duhet të auditohen në përputhje me standarde të kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë, nga auditorë të cilët do ti

përzgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike nëpërmjet një thirrje të hapur publike për aplikim.

KQZ-ja duhet t'i publikoj dhe t'i mbajtë publikuar të gjitha raportet vjetore financiare të subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike në faqen e saj zyrtare më së largu deri më 30 qershor të vitit pasues. Po ashtu, deri më këtë datë KQZ -ja obligohet t'i përcjellë subjektit politik raportin përfundimtar të auditimit.

KQZ -ja obligohet t'i përcjellë deri më 30 qershor të vitit pasues raportet vjetore financiare të subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike dhe më së largu deri më gjashtë (6) muaj pas ditës së mbajtje së zgjedhjeve raportin financiar të fushatës së subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike për në Agjencinë Anti Korruption, e cila në përpjekje me mandatin të saj mund të ekzaminoj këto raporte.

KQZ- ja përgatit një raport vjetor për Kuvendin e Republikës së Kosovës për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga Fondi.

#### **SUBJEKTET POLITIKE:**

Subjekti i regjistruar politik duhet të bashkëpunoj ngushtë me Auditorët e përzgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe u ofron atyre qasje të plotë dhe të papenguar në shënimet financiare të partisë, duke përfshirë të gjitha shënimet pa kufizime.

Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e rezultateve paraprake të kontrollimit mund ta dorëzojë raportin e rishikuar financier dhe shpjegimin lidhur me çdo gabim të dukshëm ose lëshim të identifikuar nga auditorët.

Pas pranimit të raportit të rishikuar financier nga subjekti politik dhe shpjegimet përgabimet dhe lëshimet e identifikuara, Auditorët e përzgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike brenda dhjetë (10) ditëve dorëzojnë KQZ-së Raportin Përfundimtar të Auditimit ku janë të identifikuara çdo gabim ose lëshim në raportin financier, duke marrë parasysh çdo shpjegim ose rishikim të dorëzuar nga subjekti politik. Procesi i auditimit të Raporteve vjetore financiare të subjekteve politike duhet të mbarojë më së largu deri më 15 qershor të vitit pasues.

Subjektet politike obligohen që të dërgojne për publikim në KQZ raportet vjetore financiare dhe raportet e deklarimit të fushatës, dhe të bëjnë publikimin e tyre në ueb faqen e tyre zyrtare.

Dështimi në zbatimin e politikes aktuale vjen si pasojë e dështimit të përbashjes së obligimeve ligjore nga institucionet e lartpërmendura, ku ndër të tjera poashtu vështirësi në zbatimin e kësaj politike ka qenë edhe thirrjet në paqartësitë ligjore të

Ligjit për Financimin e subjekteve politike, përkundër disa përpjekjeve të bëra nga Kuvendi për përgjedhjen e auditorëve, Kuvendi ka dështuar të bëjë përgjedhjen e auditorëve për vite me radhë, KQZ nuk ka bërë publikimin e raporteve në mungesë të auditimeve të kryera, dhe gjithashtu subjektet politike nuk kanë bërë publikimin e raporteve për të njëjtat arsyen.

Në maj të vitit 2017, me iniciativen e Organizatave jo qeveritare, është nënshkruar deklarata me subjektet politike për rritjen e transparencës gjatë fushatës zgjedhore, e cila ka për qëllim respektimin dhe zbatimin e Ligjit në ngritjen e transparencës përmënyrën e shpenzimit të parasë publike.

Përkundër zotimeve të marra me nënshkrimin e kësaj deklarate, deri më tanë subjektet politike nuk i kanë bërë publike raportet e tyre financiare.

## **LIGJET DHE AKTET NËNLIGJORE**

### **- LIGJI Nr. 03/L-174 PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE**

Ky ligj rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës.

Me këtë ligj, rregullohen poashtu burimet financiare dhe materiale të subjekteve politike në Kosovë, kontributet e dedikuara për subjektet politike, procesin e realizimit të të ardhurave nga aktivitetet e subjekteve politike etj.

Poashtu me këtë ligj parashihet edhe rregullimi dhe funksionimi i Fondit për mbështetjen e subjekteve politike, i cili funksionon në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe përcaktohet qëllimi i përdorimit të mjeteve nga ky Fond.

Poashtu në kuadër të këtij ligji rregullohet edhe procesi i raportimit financiar të subjekteve politike, kontrolli i brendshëm, kontrolli financiar si dhe dispozitat ndëshkimore ndaj subjekteve politike.

Ligji Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, është ndryshuar dhe plotësuar dy here, me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-212, gjatë viteve 2012 dhe 2013

### **- LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, ndër të tjera, ka për qëllim të rregulloj çështjet si në vijim:

- sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- financimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar dhe kriteret për pranueshmërinë e votës;
- mirëmbajtjen e listës së votuesve;
- regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike;
- përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve;
- krijimin dhe funksionimin e Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa;
- organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe këshillave të zgjedhjeve;
- rregullat për akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- kufizimet e shpenzimeve përfushatë dhe obligimet për publikim finansiar;
- mbulimin e fushatave zgjedhore nga mediat;
- kodin e mirësjelljes së subjekteve politike, kandidatëve të tyre dhe mbështetësve;
- procedurat e votimit, numërimi dhe shpalljes së rezultateve;
- sanksionet dhe gjobat e ngarkuara për shkeljen e dispozitave të këtij ligji.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256.

## **RREGULLA NR. 14/2015 PER FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE DHE SANKSIONET**

Kjo rregull ka per qellim te rregulloje procedurat per financimin, administrimin, mbiqeqyrjen, transparencen dhe raportimin per shpenzimet e pasurise dhe te ardhurave te subjekteve politike nga Fondi per mbeshtetjen e Subjekteve Politike, sanksionet per dorezimin me vonese te dokumentacioneve dhe shqiptimin e gjobave. Ne baze te kesaj rregulle, KQZ eshte autoriteti per gjegjes per ndarjen dhe menaxhimin e Fondit per mbeshtetjen e subjekteve politike, ne pajtim me ligjin per financimin e subjekteve politike. Po ashtu ne baze te kesaj rregulle, subjektet politike oglibohen te permbushin obligimet e tyre te percaktuara ne ligjin per Financimin e Subjekteve Politike dhe me rregullen e lartcekur.

### **Kapitulli III**

#### **Synimet dhe objektivat**

Synimi i përgjithshëm i kësaj politike është rritja e transparencës dhe llogaridhënieς përmes publikimit të te hyrave dhe shpenzimeve të subjekteve politike të cilët garojnë në zgjedhje.

Poashtu kjo politikë synon që të rregulloj aspektet që kanë të bëjnë me percaktimin e autoritetit per përgjedhjen e auditorëve dhe kryerjen e auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike.

Autoriteti i cili do te bej perzgjedhjen e auditoreve do te kete po ashtu mandatin per te bere monitorimin e vazhdueshem te te hyrave dhe shpenzimeve të subjekteve politike.

Synimi i kesaj politike është në përputhje me kërkesat e dalura nga Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së si dhe të Agjendës për Reforma Evropiane të cilat kërkojnë krijimin e një mekanizmi përkatës për auditimin e të dhënave, dhe publikimin e raporteve dhe deklaratave financiare të subjekteve politike.

### **1. Kritja e transparencës përmes publikimit të hyrave dhe shpenzimeve të subjekteve politike:**

Nga raportet e ndryshme të publikuara nga institucionet publike si dhe nga organizatat e ndryshme Qeveritare, vërehet se një pjesë subjekteve politike nuk i kanë të publikuara të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike, edhe pse një gjë e tillë është kërkesë e cila del nga Ligji për Financimin e subjekteve politike.

Arsyet për mos publikimin e këtyre raporteve lidhen drejtëprdrejtë me dështimin e përgjedhjes së Auditorëve, dhe në mungesë të auditimeve të subjekteve politike, këto të fundit nuk i kanë bërë publike raportet e tyre.

Ky koncept dokument synon te qartësoj më tej dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me publikimin e të hyrave dhe shpenzimet e subjekteve politike, duke rregulluar më tej dispozitën ligjore në fuqi që ka të bëjë me publikimin e raportit vjetor dhe deklaratës vjetore të subjekteve politike, si dhe duke qartësuar më tej procesin e auditimit dhe publikimit të hyrave dhe shpenzimeve të subjekteve politike. Per me teper keto dy procese nuk do te kushtezohen nga njera tjetra e cila nenkupton qe publikimi i raporteve duhet te behet nga subjektet politike dhe autoriteti përgjegjës përkatësisht KQZ-ja, pavaresisht kryerjes se auditimeve te tyre.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, konkretisht Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike, deri më tanë ka dështuar në përgjedhjen e auditorëve për të audituar raportet vjetore financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatave zgjedhore.

Pasqyrat financiare dhe raportet financiare nuk janë bërë publike pikërisht për shkak të mungesës së auditimit të këtyre pasqyrave.

Duke marrë parasysh që një shumë e caktuar e buxhetit të subjekteve politike financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, dhe në anën tjetër mos publikimi i mënyrës së shpenzimit të parasë publike e dëmton procesin e transparencës dhe llogaridhënieve, dhe pamundëson sigurimin e zbatimit të drejtë të këtyre mjeteve.

Duke u nisur nga ky fakt, meqenëse një pjesë e buxhetit të subjekteve politike financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, qytetarët duhet të kenë qasje dhe të njoftohen se si ajo para publike shpenzohet nga subjektet politike. Prandaj, ky koncept dokument adreson aspektin e transparencës dhe llogaridhënieve, dhe përmes adresimit të kësaj cështje, synohet që të gjitha të hyrat dhe shpenzimet të publikohen në kohë në mënyrë që këto të dhëna të jenë të qasshme për të gjithë.

## **2. Kryerja e auditimit të raporteve financiare**

Aktualisht, në bazë të Ligjit për financimin e subjekteve politike, Kuvendi i Republikës së Kosovës është përgjegjës për përgjedhjen e auditorëve të cilët do të bënin auditimin e raporteve financiare të subjekteve politike. Duke pas parasysh se një gjë e tillë ka dështuar të zbatohet per katër vite me radhe nga viti 2013 deri me 2017, me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike, synohet që kompetenca për përgjedhjen e auditorëve për subjektet politike të kaloj tek një organ i pavrur, përkatësisht tek Zyra për regjistrimin e subjekteve politike në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sikurse paraqitet në opzionin 2 të këtij Koncept Dokumenti. Për të mundësuar një gjë të tillë, kërkohet që Ligji për Financimin e subjekteve politike të parasheh dispozita të cilat i japin kompetencë Zyrës për regjistrimin e subjekteve politike në KQZ, për të bërë përgjedhjen e auditorëve me anë të ftesës së hapur, si dhe të jetë përgjegjëse për monitorimin e vazhdueshëm të financimit të subjekteve politike.

Poashtu, gjatë hartimit të Projektligjit, do të merret në konsideratë edhe Ligji për Administratën Shtetërore në mënyrë që kësaj zyre ti sigurohet shkallë e lartë e pavarësisë, si dhe ti sigurohet burime të nevojshme njerëzore dhe financiare për të kryer monitorimin e vazhdueshëm të financimit të subjekteve politike.

Arsye tjeter e deshtimit te kryerjes se auditimeve eshte edhe mungesa e buxhetit te mjaftueshem per kryerjen e auditimeve. Kjo cështje synohet te rregullohet përmes Fondit per Demokratizim i cili eshte i dedikuar per financimin e subjekteve politike, ndarja e shumes prej 1% te jete e dedikuar vetem per auditimin e subjekteve politike. Fondi per Demokratizim eshte deri ne vlerë prej 0.34% te buxhetit te Kosoves qe i bie ne vlerë monetare perafersisht 4 milion e 200 mijë euro. Varesisht nga buxheti i Kosoves behet edhe ndarja e mjeteve per Fondin e Demokratizimit duke perdorur formulen e ndarjes buxhetore ne vlerë prej deri ne 0.34% te buxhetit.

Nese merret si shembull vlera e deritanishme prej 4 milion e 200 mijë euro, 1% e vleres totale do te ishte 42 mijë euro te dedikuara per kryerjen e auditimeve.

## **3. Harmonizimi i sanksioneve te Ligjit per financimin e subjekteve politike me Ligjin per Kundërvajtje**

Ligji per Kundërvajtje i cili ka hyre ne fuqi ne vitin 2017 ka percaktuar limitet maksimumin dhe minimumin per sanksionet me gjobe per kundervajtje per rastet e caktuara. Ne kete aspekt, meqenese Ligji per Financimin e Subjekteve Politike ka hyre ne fuqi shume me heret, synimi i tjeter i ketij koncept dokumenti eshte harmonizimi i kundervajtjeve me dispozitat perkatese te Ligjit per Kundervajtje.

Si shembull mund te merret dispozita e nenit 21 (dispozitat ndëshkimore) paragrafi 1 e ligjit per financimin e subjekteve politike e cila përcakton gjobë bazike me 10% të shumës së realizuar nga fondi nga viti paraprak, nëse nuk paraqet raportin finanziar dhe raportin e deklarimit finanziar të fushatës, në afatin e paraparë me ligj.

Ky ligj përcakton gjoba poashtu mbi bazën e përqindjeve dhe dispozitat e tilla duhet të merren në konsidaratë gjatë ndryshimit të Projektligjit, me qëllim që ky i fundit të jetë në harmoni me Ligjin për Kundërvajtje.

Ekziston edhe një problem tjeter që duhet adresuar permes ketij Koncept Dokumenti. Rregulla nr. 14/2015 mbi financimin e subjekteve politike ka percaktuar po ashtu gjoba per mospermbushjen e obligimeve te caktuara. Percaktimi i gjobave permes akteve nenligjore eshte ceshtje e ndaluar dhe se te gjitha gjobat duhet te percaktohen me legjislacion primar duke respektuar parimin e ligjshmerise. Prandaj, te gjitha gjobat e percaktuara ne Rregullen nr. 14/2015 do te rregullohen ne Ligjin per Financimin e Subjekteve Politike.

## **Kapitulli IV**

### **Opsionet**

#### **Opzioni 1: Opzioni status quo (asnjë ndryshim)**

Duke marrë parasysh që subjektet politike dhe KQZ deri më tanë nuk kanë publikuar pasqyrat financiare të subjekteve politike, duke u thirrur në paqartësit e dispozitave ligjore të Ligjit për financimin e subjekteve politike, opzioni status quo nuk do të ndryshonte gjendjen ekzistuese, dhe rrjedhimisht subjektet politike dhe KQZ do të vazhdonin me mos publikimin e pasqyrave financiare në mungesë të kryerjes së auditimeve të pasqyrave financiare të subjekteve politike. Poashtu me përzgjedhjen e këtij opzioni, nuk do të adresoheshin këkresat e dala nga PKZMSA dhe ERA.

#### **Opzioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese**

Duke pas parasysh dështimin e vazhdueshëm të zbatimit të dispozitave ligjore të Ligjit për financimin e subjekteve politike që kanë të bëjnë me transparencën dhe

Ilogaridhënien e subjekteve politike në procesin e financimit të tyre dhe shpenzimeve të kryera, dhe rrjedhimisht edhe mos publikimin e raporteve financiare të subjekteve politike, opsioni i rekomanduar nga ekipi përgjegjës për hartimin e këtij koncept dokumenti është ndryshimi i Ligjit për financimin e subjekteve politike, me theks të veçante duke përcaktuar dispozita të qarta dhe precise për procesin e përzgjedhjes së auditorëve të licencuar, kryerjen e auditimit të raporteve financiare, si dhe obligimit për publikimin e këtyre raporteve nga subjektet politike në KQZ.

Ekipi punues ka dalë me propozimin që në kuadër të ndryshimeve të dispozitave ligjore të Ligjit për financimin e subjekteve politike, të përcaktohet që përzgjedhja e auditorëve të licencuar për kryerjen e auditimeve të raporteve financiare të subjekteve politike të bëhet nga Zyra për regjistrimin e subjekteve politike në kuadër të KQZ-së.

Pra, në këtë drejtim, Zyra me anë të ftesës së hapur, do të përzgjedh auditorët e licencuar, të cilët do ti kryenin auditimet e raporteve financiare të subjektit politik dhe raportet e shpenzimeve gjatë fushatës, të cilat raporte gjithashtu do të publikohen në ueb faqen e subjektit politik dhe në ueb faqen zyrtare të KQZ-së.

Me qëllim të realizimit të këtij opzioni, do të inicohet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për financimin e subjekteve politike, për të adresuar kërkesat e dalura nga Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe nga Agjenda për Reforma Evropiane.

Përkundër asaj që u theksua më lartë, ekipi përgjegjës deri te opsioni i rekomanduar ka ardhë pasi ka marrë ne konsideratë edhe mundësitet si në vijim:

1. PZAP si organ i pavarur për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave, i krijuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, të kryente procedurat e përzgjedhjes së auditorëve të licencuar, për kryerjen e auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike.

Nëse kjo përgjegjësi do ti caktohej PZAP-it, kjo do të nënkuptonte që PZAP ti rris kapacitetet institucionale, dhe ti rritet buxheti me qëllim të realizimit të kësaj përgjegjësie.

2. Zyra Kombëtare e Auditimit si mekanizëm i pavarur i themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjit, të kryente auditimin e raporteve financiare të subjekteve politike, pasi që ky institucion i plotëson të gjitha kushtet profesionale.

Por, me qëllim të realizimit të kësaj ideje, ekziston një pengesë kushtetuese për sa i takon kompetencës së ZKA-së, për të audituar edhe burimet e tjera të financimit për subjektet politike që nuk vijnë nga Buxheti i Kosovës, por nga burimet e tjera si anëtarësia, donacionet etj.

3. Agjencia kundër Korruptionit, si institucion i pavarur, ti jepej kompetenca përmes ndryshimeve ligjore, për kryerjen e procedurave të përgjedhjes së auditorëve të licencuar, për kryerjen e auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike.

Por meqenëse ky institucion nuk është i profesionalizuar në cështjet e përgjedhjes së auditorëve dhe kryerjes së auditimeve të raporteve financiare, nëse kjo kompetencë do ti përcaktohej këtij institicioni, do të ishte e nevojshme që stafi ekzistues të përgatitet dhe të trajnohet, dhe do të merren parasysh ndryshimet e ligjit për agjencinë kundër korruption, me qëllim që të harmonizohet me ligjin për financimin e subjekteve politike.

#### 4. Kryerja e auditimit të raporteve financiare nga vet subjektet politike:

Kryerja e auditimit nga vet subjektet politike, do të mundësohej përmes përgjedhjes se auditorëve të licencuar nga vet subjektet politike, të cilët do të kryenin auditimin e raporteve financiare të hyrave dhe shpenzimeve të subjekteve politike, dhe këto raporte më pastaj do të publikoheshin në ueb faqet zyrtare të subjekteve politike, dhe do të dëgoheshin për publikim në KQZ.

Me qëllim të realizimit të këtij opzioni, është e nevojshme ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për financimin e subjekteve politike, me qëllim të adresimit të cështjeve të lartpërmendura në kuadër të ligjit.

Gjatë ndryshimeve ligjore, do të merreshin në konsideratë që të ofrohen lehtësira financiare për subjektet politike, në mënyrë që ti përballojnë shpenzimet që kanë të bëjnë me përgjedhjen e auditorëve të licencuar për kryerjen e auditimeve. Një mundësi do të ishte që një përqindje e caktuar nga Fondi për subjektet politike i cili u dedikohet subjekteve politike, të jet i dedikuar për subjektet politike, me qëllim të realizimit të përgjedhjes së auditorëve të licencuar dhe kryerjen e auditimeve.

#### Opzioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit do të nënkuptonte forcimin e zbatimit të Ligjit ekzistues për financimin e subjekteve politike, por që kjo bartë në vete rrezikun e vazhdimit të gjendjes ekzistuese duke u thirrur në paqartësitë e dispozitave ligjore të ligjit për financimin e subjekteve politike.

Nevoja për ndryshimin e ligjit për financimin e subjekteve politike është edhe detyrim që del nga dy dokumentet (PKZMSA dhe ERA), dhe se në këtë rast opzioni 3 nuk do të adresonte kërkesat e dala nga këto dy dokumente.

Poashtu, ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit do të pamundësonte funksionimin e mirfilltë të transparencës dhe llogaridhënieve në procesin e financimit dhe shpenzimeve të subjekteve politike.

## Kapitulli V

### Përbledhja e opsiioneve

Përbledhje e Opsiioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsiuni 1	Opsiuni 2	Opsiuni 3
Karakteristikat kryesore të opzionit	Gjendja e pandryshuar (jo e dëshirueshme)	Rritja e transparencës dhe llogaridhënieve përmes përzgjedhjes së auditorëve nga Zyra për Regjistrimin e subjekteve politike, dhe monitorimin e vazhdueshëm të financimit të subjekteve politike nga kjo Zyrë, për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie të subjekteve politike.	Forcimi i zbatimi i dispozitave ligjore të Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, rritja e transparencës dhe llogaridhënieve me publikimin e te hyrave dhe shpenzimeve te subjekteve politike, përzgjedhja e Auditorëve nga Kuvendi i Kosovës për kryerjen e auditimeve të raporteve financiare të subjekteve politike, dhe publikimi I këtyre raporteve

			nga KQZ.
Segmenti i popullsisë/sekitori/rajoni i shënjestruar	Kosova	Kosova	Kosova
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Kuvendi i Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Kuvendi i Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Kuvendi i Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	-	-	-
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Ligji nr. 03/l-174 për financimin e subjekteve politike i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-058 dhe ligjin nr. 04/l-212	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e subjekteve politike	<b>LIGJI NR. 03/L-174 PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE</b>
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike - subvencionet ose taksat	-	-	-
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	-	-	-
Udhëzimet dhe kodet	-	-	-
Afatet kohore - kur hyn në fuqi opzioni	K1 2018	K1 2018	K1 2018

## Kapitulli VI

### Analiza e opsiioneve

#### 1. Përfitimet e opzionit 1 (status quo):

Ky opsjon konsiderojmë se nuk është i përshtatshëm për arsyen se me vazhdimin e zbatimit të gjendjes së status quo, do të vazhdohej gjendja e tanishme dhe rrjedhimisht subjektet politike dhe KQZ do të vazhdonin me mos publikimin e pasqyrave financiare në mungesë të kryerjes së auditimeve të pasqyrave financiare të subjekteve politike.

Kjo do të reflektonte poashtu negativisht në marrjen e obligimeve të dala nga PKZMSA dhe ERA, si dhe do të shkaktonte ngecje në përmbushjen e obligimeve të dala nga Agjenda Evropiane.

## **2. Përfitimet e opsonit 2 (opsioni i rekomanduar)**

Ekipi punues ka dalë me propozimin që në kuadër të ndryshimeve të dispozitave ligjore të Ligjit për financimin e subjekteve politike, të përcaktohet që përzgjedhja e auditorëve të licencuar për kryerjen e auditimeve të raporteve financiare të subjekteve politike të bëhet nga Zyra për regjistrimin e subjekteve politike në kuadër të KQZ-së.

Kjo do të nënkuptonte që gjatë ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Financimin e subjekteve politike do të merret në konsideratë edhe Ligji për Administratën Shtetërorë në mënyrë që kësaj zyre ti sigurohet shkallë e lartë e pavarësisë organizative dhe funksionale për të siguruar se Zyra për regjistrimin e subjekteve politike të funksiononte e pavarur nga KQZ, vetëm me mbështetje administrative dhe logistike të Sekretariatit të KQZ. Gjithashtu, me anë të Ligjit do të merret në konsideratë sigurimi i burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për të kryer monitorimin e vazhdueshëm të financimit të subjekteve politike.

## **3. Përfitimet e opsonit 3**

Me implementimin e këtij opzioni, nuk do të ishte e nevojshme ndryshimi i kornizës ligjore që ka të bëjë me financimin e subjekteve politike, por që kjo do të kërkonte një ndryshim të qasjes së zbatimit të ligjit, duke kërkuar nga institucionet dhe subjektet politike që të kryejnë auditimet e pasqyrave financiare, dhe të kërkohet publikimi i tyre nga KQZ dhe subjektet politike.

## **Kapitulli VII**

### **Krahasimi i opioneve**

1. Opsiuni i parë nënkupton vazhdimin e gjendjes ekzistuese, pra që nënkupton vazhdimin e praktikës së deritanishme të mos publikimit të raporteve financiare nga subjektet politike dhe KQZ, si dhe mos kryerjen e auditimeve të këtyre raporteve financiare.
2. Opsiuni i dytë nënkupton ndryshimin e politikes ekzistuese me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financimin e subjekteve politike, duke siguruar që

në ligjin e ri të përcaktohen dispozita të qarta dhe prezise për procesin e përgjedhjes së auditorëve të licencuar nga Zyra për regjistrimin e subjekteve politike, kryerjen e auditimit të raporteve financiare, si dhe obligimit për publikimin e këtyre raporteve nga subjektet politike dhe KQZ-ja. Në kuadër të këtyre ndryshimeve ligjore, do të përcaktohet që përgjedhja e auditorëve të licencuar për kryerjen e auditimeve të raporteve financiare të subjekteve politike të bëhet nga Zyra për regjistrimin e subjekteve politike. Pra, në këtë drejtim, Zyra me anë të ftesës së hapur, do të përgjedh auditorët e licencuar, të cilët do ti kryenin auditimet e raporteve financiare të subjektit politik dhe raportet e shpenzimeve gjatë fushatës, të cilat raporte me pastaj do të publikohen nga vet subjekti politik dhe në ueb faqen zyrtare të KQZ-së.

Poashtu, Zyra do të jetë përgjegjëse për monitorimin e vazhdueshëm të financimit të subjekteve politike, dhe nëse marrim parasysh mandatin e KQZ-së, e cila merret me të gjitha aspektet e subjekteve politike, kjo nënkuption që monitorimi do të ishte shumë më i lehtë të kryhej në krahasim me përcaktimin e kësaj kompetencë në ndonjë Institucion tjetër i cili nuk e ka ekspertizën për të kryer një gjë të tillë.

3. Opsiioni i tretë poashtu është një opsiion i cili sipas analizave paraprake të bëra, nuk do të sjellë ndryshime të dëshirueshme, pasi që konsiderojmë se miratimi i këtij opzioni nuk do të arrinte të siguronte transparencë dhe llogaridhënie nga subjektet politike.

Pra, bazuar në gjendjen e paraqitur në opzionet e lartcekura, ne rekomandojmë që Qeveria e Republikës së Kosovës të miratoj **opzioni 2** të paraqitur në këtë Koncept Dokument.

## Kapitulli VIII Rekomandimi

Me miratimin e opzionit 2 të propozuar do të mundësohej:

- Inicimi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Financimin e subjekteve politike;
- Përgjedhja e auditorëve të licencuar nga Zyra për regjistrimin e subjekteve politike në KQZ dhe monitorimi i vazhdueshëm i financimit të subjekteve politike;
- Rishikimi i kritereve për përgjedhjen e auditorëve të licencuar;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënieve përmes publikimit të raporteve financiare nga subjektet politike;
- Harmonizimi i dispozitave për kundërvajtje me Ligjin për Kundërvajtje.

**Inicimi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Financimin e subjekteve politike**  
Me miratimin e opsonit 2 të këtij koncept dokumenti, do të hapet rruga për inicimin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit, ku do të ndryshohen dispozitat e ligjit që kanë të bëjnë me kryerjen e auditimeve të raporteve financiare të subjekteve politike, si dhe dispozitat që kanë të bëjnë me përgjedhjen e auditorëve.

Në këtë aspekt, duke marrë parasysh analizën e paraqitur në këtë koncept dokument, me projektligj do të përcaktohet që Zyra për regjistrimin e subjekteve politike të bëjë përgjedhjen e auditorëve, si dhe e njëjtë të ketë kompetencën e monitorimit të vazhdueshëm të financimit të subjekteve politike. Ky opson poashtu adreson kërkesat e dalura nga PKZMSA dhe ERA, si dhe mundëson transaprençë dhe llogaridhënie të mënyrës së shpenzimit të mjeteve financiare të subjekteve politike.

Gjatë ndryshimeve ligjore, do të merret në konsideratë e tërë korniza ligjore që e rregullon fushën e subjekteve politike, dhe në këtë rast do të shikohet edhe nevoja e ndryshimit të rregullores së KQZ-së që ka të bëjë me financimin e subjekteve politike, me qëllim që të sigurohet harmonizimi i kornizës ligjore.

#### **Rishikimi i kritereve për përgjedhjen e auditorëve të licencuar**

Neni 11 i Ligji nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-058, i cili e ndryshon Nenin 19 të ligjit bazik që ka të bëjë me kontrollin financier, pjesa që ka të bëjë me kriteret e përgjedhjes së auditorëve të licencuar duhet të rishikohet, dhe të përcaktohen kriteret që cilat do të jenë të zbatueshme në praktikë.

Si shembull mund të marrim kërkesën që është e përcaktuar në këtë dispozitë të ligjit, që Kuvendi i Republikës së Kosovës bën përgjedhjen përmes konkursit publik të së paku 10 auditorëve të licencuar si pjesë përbërëse e personit juridik për auditimin e raporteve të subjekteve politike dhe duhet ti përm bushin të gjitha kriteret e përcaktuara në ligj. Numri i auditorëve do të merret në konsideratë që të ulet, si dhe poashtu do të rishikohen kriteret tjera për përgjedhjen e auditorëve.

#### **Rritja e transparencës dhe llogaridhënie përmes publikimit të raporteve financiare nga subjektet politike**

Përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për financimin e subjekteve politike, do të definohet në mënyrë precize obligimi i publikimit të raporteve financiare nga ana e vet subjekteve politike në ueb faqet e tyre zyrtare, por pa u kushtëzuar me auditimin e këtyre raporteve, duke i pa si dy procese të ndara njëra nga tjetra.

Poashtu, do të përcaktohet obligimi që subjektet politike përveç publikimit të raporteve në ueb faqet e tyre zyrtare, një kopje të saj ta dërgojnë në Zyren për regjistrimin e subjekteve politike, e cila do ta bëjë publikimin e të njëjtë raporteve në ueb faqen e saj zyrtare.

### **Harmonizimi i dispozitave për kundërvajtje me Ligjin për Kundërvajtje**

Inicimi i ndryshimit të ligjit për financimin e subjekteve politike, do të mundësonte harmonizimin e kundërvajtjeve me dispozitat përkatëse me Ligjin për Kundërvajtje.

Bazuar në gjendjen e paraqitur në këtë koncept dokument, si dhe duke u bazuar në praktikat e deritashme të zbatimi të Ligjit për financimin e subjekteve politike, Qeverisë së Kosovës i rekomandojmë për miratim **opsionin nr. 2**